



Prishtinë 30/06/2005
Kodi i ZRrE: D_03_2005

Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/10 “ Mbi Elektricitetin”;
3. Propozimin e paraqitur nga Korporata Energjetike e Kosovës (“KEK”) në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (“ZRrE”) më 27 prill 2005;
4. Komentet ndaj propozimit, të siguruara prej ZRrE-së më 31 maj 2005, dhe takimin me KEK mbajtur më 2 qershor 2005;
5. Propozimet e rishikuara të KEK-ut më datën 29 dhe 31 maj 2005, komentet e paraqitura prej ZRrE-së më 9 qershor 2005 dhe përgjigjen e KEK-ut ndaj komenteve dhe takimit më 22 qershor 2005;
6. Kërkesën përfundimtare të KEK-ut më 27 qershor 2005

Ka vendosur të:

Miratojë kërkesën e KEK-ut në lidhje me “Procedurën dhe Çmimet e Shërbimit Lidhës” për sa i përket formës përfundimtare të paraqitur më 27 qershor 2005 dhe i nënshtruar ndaj procedurave që përfshihen në Kapitullin I të këtij Vendimi.

Kapitulli 1: Procedura Lidhëse

1. Aplikueshmëria – ZRrE-së do t'i paraqiten për aprovim standarde minimale teknike, brenda një periudhe kohore deri në 3 muaj, duke filluar prej datës në të cilën hyn në fuqi ky Vendim.
2. Ky Vendim do të botohet nga KEK, në të paktën një gazetë lokale me qarkullim të gjerë nëpër Kosovë, 5 ditë pune pas datës së botimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.
3. KEK-u ka të drejtën të apelojë në ZRrE duke paraqitur një raport plotësisht të qëndrueshëm, 14 ditë pune pasi të jetë bërë lajmërimi dhe botimi i këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.
4. KEK-u do të fillojë të zbatojë dispozitat e këtij vendimi, që prej datës së botimit të tij të parë nga ZRrE.
5. Ky Vendim do të ndryshohet ose zëvendësohet nga Rregullorja përkatëse që nxjerr Bordi i ZRrE-së, siç përcaktohet në Nenin 58 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

Në emër të ZRrE-së
Dr. Nick F Frydas
Kryetar i Bordit